



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 122 Akti

**Nr. 125 Vendimi
Tiranë më 26.03.2019**

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Suela Zhegu
Brunilda Bekteshi
Xhensila Pine**

**Kryesuese
Relatore
Anëtar**

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar Z. Ferdinando Buatier, në Tiranë, më datë 25 mars 2019, ora 11:30, në Pallatin e Kongreseve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Fatmir M. Lushi, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Elbasan, i paraqitur personalisht, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b, paragrafi 5 dhe neni Ç, paragrafi 1, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;**

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, komisioneren Brunilda Bekteshi, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e tij, në seancë dëgjimore publike vlerësimin kalimtar ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Fatmir M. Lushi, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Fatmir Lushi, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe referuar pikës 3, të nenit 179/b të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) janë administruar raportet e hartuara nga: 1) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); 2) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); 3) Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme (në vijim “GPPP”).

3. Trupi gjykues nr. 3, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me hedhjen e shortit, më datë 15.03.2018, me vendimin nr. 1, datë 20.03.2018, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues, komisionere Suela Zhegu. Po ashtu, të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

4. Më datë 07.06.2018, subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike për përbërjen e trupit gjykues, për të cilën subjekti i rivlerësimit, më datë 08.06.2018, deklaroi se në dijeninë e tij nuk ishte në konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatores së çështjes, me vendimin nr. 2, datë 04.03.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Fatmir Lushi, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Më datë 07.03.2019, me anë të postës elektronike, trupi gjykues, njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht, për dy kritere, të pasurisë dhe kriterit të figurës; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda datës 18.03.2019, nga data e njoftimit; (iii) për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016.

7. Më datë 18.03.2019, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, solli shpjegimet e tij së bashku me provat, të cilat u administruan nga ana e Komisionit, të cilat u dërguan me anë të postës elektronike dhe në protokollin e institucionit.

8. Më datë 20.03.2019, trupi gjykues nr. 3, me vendimin nr. 2, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Fatmir Lushi, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej, më datë 25.03.2019, ora 09:30 paradite, në ambientet e Pallatit të Kongreseve.

9. Në këtë njoftim, Komisioni bëri me dije subjektin e rivlerësimit se mbi kërkesat e paraqitura nga ana e tij, për këqyrje dokumentesh, në funksion të procedimit penal nr. (***) , viti 2016, për thirrje të dëshmitarëve për pasuritë, subjektit iu refuzuan këto kërkesa, duke rezervuar të drejtën të japë arsyetimin e tyre, së bashku me vendimin përfundimtar.

10. Në mbështetje të pikës 6 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, kërkesat e subjektit të rivlerësimit sipas pikës 9, trupi gjykues i konsideroi të panevojshme, dhe për rrjedhojë i refuzoi ato për arsyet e mëposhtme:

10.1 Mbi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, për thirrjen e dëshmitarëve, shtetasit Q. L., H. L., D. Ç., B. L., si anëtarë të familjes së shtetasit M. L., për të deklaruar në lidhje me të ardhurat e familjes së M. L.; shtetasin S. Q. D., me cilësinë e kryeplakut të fshatit K., për të dhënë shpjegime në lidhje me të ardhurat e familjes së M. L., të vetëpunësuar në bujqësi dhe blegtori, të punësuar në punë sezonale, gjatë realizimit të investimeve në fshat; shtetasi M. H. P., anëtar i Pleqësisë së fshatit K.; shtetasi Q. B. L., anëtar i Pleqësisë së fshatit K.; shtetasi A. Q. V., banues në fshatin K.; shtetasin F. A. Sh., i cili ka punësuar shtetasit M. L. dhe H. L. në punë sezonale; si dhe shtetasin A. Xh. A., administrator i shoqërisë “F.” sh.p.k., që kanë punësuar M. L. dhe H. L. në punë sezonale, vlerësoi se:

10.2 Deklarimi i tyre nuk mund të konkurrojë në raport me analizën e bërë në raportin e auditit ligjor, për të cilin është argumentuar gjerësisht në pasurinë nr. 1. Po ashtu, Komisioni, refuzoi pyetjen e dëshmitarëve të cilët kanë punësuar familjarë të subjektit të rivlerësimit për shkak se, qëllimi nuk ka qenë të deklarohej nëse dëshmitarët kanë punësuar ose jo familjarët e subjektit, por të provohej nga vetë subjekti i rivlerësimit burimi i ligjshëm i krijimit të të ardhurave të siguruara nga këto punësime.

10.3 Trupi gjykues e konsideroi të panevojshme marrjen e dëshmive të kërkuara nga subjekti i rivlerësimit, të shtetasve Q. L., D. Ç., M. L., si anëtarë të familjes, për arsye se, fakti që kërkohet të provohej nga subjekti i rivlerësimit, konsiderohet i provuar gjatë hetimit administrativ, ku subjekti ka paraqitur deklarata noteriale të këtyre shtetasve.

10.4 Trupi gjykues refuzoi të pyesë Oficeren e Policisë Gjyqësore, znj. M. K., për faktin se në raport me dëshminë e saj, vlerë të pakontestueshme ka referimi i bërë nga ana e saj, në procedimin penal.

10.5 Trupi gjykues refuzoi edhe kërkesën tjetër të subjektit të rivlerësimit për të këqyruar këtë dokumentacion, në funksion të procedimit penal nr. (***) , të vitit 2016, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, në Drejtorinë për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar, që varet nga Drejtoria e Përgjithshme për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, pranë Drejtorisë së Policisë së Shtetit, me pretendimin, se nga kjo këqyrje do të provohet që ai material operativ është për shumë persona me banim në disa qytete të Shqipërisë, dhe disa shtete Itali, Kosovë, dhe Maqedoni dhe personat e tjerë ndiqeshin në kuadër të përgjimeve parandaluese, jo procedurale, pasi gjetjet e Komisionit në këtë procedim penal janë bazuar në analizimin e veprimeve hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, sikurse rezulton nga aktet e administruara në këtë fashikull penal, si dhe për faktin se këqyrja e dokumenteve nuk mund të tjetërsojë rrethanat e çështjes.

11. Më datë 21.03.2019, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 3, datë 20.03.2019, vendosi të ftojë, subjektin e rivlerësimit, z. Fatmir Lushi, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej, më datë 25.03.2019, ora 11:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

12. Më datë 25.03.2019, u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Fatmir Lushi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Fatmir Lushi, iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar, shprehu qëndrimin e tij, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Fatmir Lushi, kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Fatmir Lushi. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 25.03.2019, për ta rifilluar, më datë 26.03.2019, ora 13:30, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Fatmir Lushi, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, në drejtim të respektimit të afateve të përcaktuara, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) raportin mbi Kontrollin e Figurës, të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja, i deklasifikuar;
- d) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- e) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik;
- f) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative si dhe argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore - për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

1.1 DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës, të deklasifikuar pjesërisht¹, për subjektin e rivlerësimit, ku në rastin në fjalë, me cilësinë e prokurorit, përfshihet në veprime korruptive në dy çështje të ndryshme, të cilat i referohen verifikimeve të autoriteteve verifikuese. Ky raport ndër të tjera ka pasqyruar se:

- ✓ Disponohen të dhëna se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar një shtetas të proceduar penalisht për falsifikim dhe hedhje në treg të kartëmonedhave të jashtëligjshme, kundrejt një shume të caktuar parash gjatë kohës në të cilën ka ushtruar detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
 - ✓ Disponohen të dhëna se subjekti i rivlerësimit ka favorizuar një shtetas të proceduar penalisht, kundrejt një shume të caktuar parash gjatë kohës në të cilën ka ushtruar detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
- a- Kjo veprimtari e paligjshme i përmbahet përcaktimit të pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ku përfshihen veprat penale të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale “Krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni”.
 - b- Informacioni që disponohet në ngarkim të z. Fatmir Lushi, për veprimtari korruptive, evidenton rrethanat e konstatimit të faktit, se ekziston kontakt i papërshtatshëm, sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, në formën e takimit të qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.
 - c- Veprimtaria korruptive e subjektit të rivlerësimit cenon drejtpërdrejtë pastërtinë e figurës, çfarë përmbush plotësisht përcaktimin e germës “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, ku z. Fatmir Lushi vlerësohet si individ i mundshëm për t’u vënë nën presion nga struktura kriminale.
 - d- Në këto konkludime, institucioni i DSIK-së ka mbajtur në konsideratë edhe aktualitetin e të dhënave.

1.2 Për sa më sipër, në vlerësim të të dhënave për subjektin e rivlerësimit, Grupi i Punës, ka konfirmuar konstatimin për *papërshtatshmërinë* për ushtrimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Fatmir Lushi, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

1.3 Hetimi i kryer nga Komisioni për kontrollin e figurës

1.3.1 Trupi gjykues së bashku me vëzhguesin ndërkombëtar, pasi studiuan informacionin e klasifikuar, kërkuan² rishikimin e raportit. Institucioni i DSIK-së³, dërgoi raportin me të dhëna shtesë për kontrollin e figurës, duke konfirmuar konstatimin fillestar për papërshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës. Në lidhje me rastet korruptive të raportuara nga institucionet ligjzbatuese, Komisioni, ka kryer verifikimet dhe ka kërkuar dosjet gjyqësore përkatëse për të cilat kishte raportime për korrupsion, të cilat i referoheshin çështjeve të mëposhtme:

- **Çështja penale, që i përket vendimit “Për pushimin e çështjes”, mbi procedimin penal nr. (***) , të vitit 2016⁴.**

1.4 Kjo çështje rezulton të jetë regjistruar në ngarkim të shtetasve me iniciale D. H dhe D. Ç., për kryerjen e veprave penale të “Korrupsion pasiv në sektorin privat” dhe “Falsifikim i monedhave” në bashkëpunim, që parashikohet nga neni 164/b dhe 183/2 të Kodit Penal, për të cilën subjekti ka vendosur pushimin e saj.

¹ Deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së, nr. (***) , datë 19.02.2019.

² Referuar shkresës nr. (***) prot., datë 22.01.2019, në dosjen e Komisionit.

³ Referuar shkresës nr. (***) prot., datë 07.02.2019, në dosjen e Komisionit.

⁴ Për këtë çështje ka dhënë opinion ligjor edhe Prokuroria e Përgjithshme, pas kërkesës së Komisionit. Referojuni opinionit në dosjen e Komisionit.

1.5 Nga verifikimi dhe analizimi i fashikullit hetimor Komisionit i rezultoi se:

Në dosje nuk ishin administruar akte mbi zbatimin e autorizimeve “Për përgjimin”, sikurse subjekti kishte kërkuar të dorëzoheshin raporte përmbledhëse.

1.5.1 Komisioni ka konstatuar se nga subjekti nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim, që i mundëson procedura penale, nëpërmjet letër porosisë, sipas parashikimit të nenit 332/ç të Kodit Penal, për të siguruar kartëmonedhën false me cilësinë e provës.

1.5.2 Gjatë veprimeve hetimore mbi vënien në përgjim të numrave të telefonit për shtetasit e akuzuar, Komisioni, konstatoi se subjekti kishte kërkuar përgjimin e një numri telefoni të ndryshëm nga ai që identifikohet se përdorej nga i akuzuari dhe për pasojë edhe gjykata është shprehur gabim.

1.5.3 Nuk kishte arsyetuar se kur dhe si kishte rënë në dijeni të faktit se ky numër ishte i të akuzuarit, si dhe:

1.5.4 Komisioni vërejt: megjithëse nga ana e subjektit argumentohet se nga transkriptimi i bisedave telefonike “...krijohen dyshime për kryerje veprimesh të paligjshme, dhe se rezultonte e nevojshme që të zgjatej afati i përgjimit, në vendimin e pushimit, subjekti ka arsyetuar se, nga përgjimet nuk mësohet ndonjë e dhënë me interes për hetimin.”

1.5.5 Rezulton se, në dosje nuk janë administruar aktet që provonin përgjimin, si dhe subjekti me kërkesën e tij ka kërkuar asgjësimin e tyre.

1.6 Mbi hetimin e kësaj dosjeje, nga ana e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, konstatoi se, edhe pse Drejtoria e Policisë Vendore Elbasan, “pas kërkesës së subjektit për këqyrje banese”, kishte informuar se veprime të tilla “...do të pengonin hetimin e strukturave të tjera”, nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim që mund të konfirmonte vërtetësinë e përmbajtjes së përgjigjes së Drejtorisë së Policisë Vendore Elbasan.

1.7 Nuk ishte kryer asnjë veprim procedural për të verifikuar nëse prokuroritë e tjera kishin të regjistruar ose jo si persona nën hetim shtetasit e akuzuar për të njëjtën veprë penale që po i hetonte Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, apo për vepra penale të tjera. Mbi këtë konstatim të Komisionit është shprehur edhe Prokuroria e Përgjithshme në opinionin e saj pas kërkesës së Komisionit.

1.8 Komisioni, në analizim të kësaj dosjeje, ka konstatuar se, edhe pse nga deklaratimet e shtetasve që kishin dijeni për veprën penale, ishin marrë deklaratime mbi aktivitete private, ushtrime biznesi, si dhe përdorim automjeti, subjekti nuk kishte kryer asnjë veprim hetimor mbi vërtetësinë dhe ligjshmërinë e tyre, në një kohë që çështja i referohej kryerjes së veprave penale të “Korrupsionit pasiv në sektorin privat” dhe “Falsifikimit të monedhave”.

Për sa më sipër, Komisioni, i kaloi barrën e provës subjektit pasi në këtë çështje penale, dukej se:

- ✓ Subjekti i rivlerësimit nuk kishte kryer një hetim të plotë, si dhe nuk kishte siguruar provat e kërkuara për qartësimin e rrethanave të aktit korruptiv; *si dhe*
- ✓ Subjekti kishte favorizuar shtetasit nën hetim, akuzuar për “Korrupsion pasiv në sektorin privat” dhe “Falsifikim i monedhave”.

1.9 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet mbi kriterin e figurës.

1.9.1 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se konstatimet e Komisionit, duke iu referuar shpjegimeve dhe provave që ka depozituar, si dhe për sa referohej në raportin e DSIK-së, ishin të pabazuara. Mbi konstatimet e Komisionit se, procedimi penal nr. (***) fillon mbi bazën e referimit nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, subjekti ka deklaruar se nuk i kishte parë aktet, se kishin vazhduar paralelisht hetime në rrethet e tjera nga struktura të tjera, se dhe një procedim penal nuk mund të mbahet pafundësisht. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që të pyetet Oficerja e Policisë Gjyqësore, pasi ka bërë referimin e veprës penale, si dhe ka qenë pika e kontaktit me Sektorin e Forcës së Posaçme Operacionale, si dhe pika e kontaktit me oficerin e përgjimeve në Prokurorinë e Përgjithshme. Kallëzimi penal kishte shërbyer si një arsye për t'u kthyer në referim penal. Marrja në pyetje e dy personave në hetim ishte kryer në prezencë të Oficeres së Policisë Gjyqësore, e cila nuk kishte nënshkruar në akt. Gjykata kishte parë rezultatin e përgjimit dhe në përfundim me kërkesën e tij, ka urdhëruar asgjësimin e tyre.

1.10 Trupi gjykues, në analizim të veprimeve hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit në fashikullin penal, si dhe pas qëndrimit të tij, çmon se:

Regjistrimi i procedimit penal është rezultat i kallëzimit të bërë, më datë 01.06.2016, nga shtetasi K. B., për të cilin Oficerja e Policisë Gjyqësore, ka bërë referimin e veprave penale përkatëse, provë e administruar në dosjen hetimore, ku ka pasqyruar të gjithë veprimet e ndërmarra, informacionin e mbledhur si dhe mendimet e dhëna në referimin e veprës penale organit të prokurorisë, akt i nënshkruar prej saj. Ndryshe nga çfarë ka pasqyruar dhe është shprehur OPGJ-ja në referimin e saj se, “...mendojmë që konstatohen elementë të veprës penale, ‘Pastrim i produkteve të veprës penale’ ...”, subjekti i rivlerësimit, ka regjistruar procedimin penal vetëm për dy veprat penale të lartpërmendura, “Korrupsion pasiv në sektorin privat” dhe “Falsifikim i monedhave”. Në asnjë prej akteve të mbajtura nga subjekti i rivlerësimit nuk është pasqyruar fakti se përse është shmangur hetimi për kryerjen ose jo të veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale. Ndryshe nga qëndrimi i mbajtur nga OPGJ-ja në referimin, më datë 02.06.2016, në të cilin ka cilësuar se “...nga ana e tyre për shtetasit H. dhe D. Ç.” disponohen të dhëna të mëparshme operative – legale se shtetasi Ç. po kryen veprimtari kriminale në drejtim të falsifikimit të kartëmonedhave dhe çngjyrosjes së tyre të vjedhura në banka të BE-së “...ka të dhëna se pastrimi i parave të vjedhura është arritur të kryhet nga këta shtetas... në këtë aktivitet ka të dhëna në rrugë operative se këta shtetas bashkëpunojnë me persona të tjerë në rrethin e Durrësit,” subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë veprime hetimore, për të verifikuar vërtetësinë dhe për të zbardhur faktet dhe rrethanat e referuara nga OPGJ-ja.

Mungesa e veprimeve hetimore ka konsistuar gjithashtu edhe në moskryerjen e veprimeve procedurale për të verifikuar nëse prokuroritë e tjera kishin të regjistruar ose jo si persona nën hetim shtetasit D. H. dhe D. Ç. për të njëjtën vepër penale që po i hetonte Prokuroria Elbasan, apo për vepra penale të tjera, dhe për pasojë rezulton se, subjekti i rivlerësimit i është shmangur bashkërendimit të punës me prokuroritë e tjera që mund të pasillte aplikimin e nenit 306 të Kodit të Procedurës Penale. Në pretendimet e paraqitura subjekti synon të arsyetojë fakte dhe rrethana të cilat duhej t'i kishte pasqyruar në veprimet e kryera prej tij, si dhe atyre të deleguara për OPGJ-në, sipas nenit 30/2 të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme administrimin e po atyre akteve që janë të administruara në fashikullin penal, mbi të cilët Komisioni kreu hetimin dhe i kaloi barrën e provës.

Në përfundim, për çështjen penale për të cilën kishte konstatime për përfshirje në veprime korruptive, trupi gjykues, çmon se:

- ✓ Hetimi nuk është i plotë, si dhe nuk janë mbledhur të gjitha provat e kërkuara për qartësimin e rrethanave të aktit korruptiv.

2. Mbi çështjen tjetër penale që DSIK-ja, kishte konkluduar për dyshime për veprime korruptive, Komisioni administroi dhe analizoi dosjen penale të hetuar nga subjekti, nga ku rezultoi se:

2.1 Ky procedimi penal rezulton, se ishte regjistruar për veprat penale të “Plagosjes së rëndë me dashje” dhe “Mbajtjes pa leje të armëve të ftohta”.

2.2 Nga rrethanat e çështjes, referohej një ngjarje në vitin 2010, e ndodhur në një drekë të organizuar nga kryetari i Këshillit të Komunës H., z. L. B., ku ndër të tjerë kishte marrë pjesë edhe i pandehuri Gj. L. . Pas përfundimit dhe largimit nga ky organizim, i pandehuri Gj. L. në një sherr me shtetasin Z. Gj., ka nxjerrë një thikë dhe e ka goditur... I pyetur me cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, shtetasi Gj. L. ka mohuar faktin që i atribuohet.

2.3 Nga aktet e administruara në dosje, Komisioni, konstatoi se nga subjekti nuk ishin kryer veprime hetimore lidhur me veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve të ftohta”, si dhe:

➤ Dukej se subjekti, edhe pse në konkluzionet përfundimtare, kishte renditur rrethana që rëndojnë pozitën e të pandehurit, të tilla si:

- i. i pandehuri ka mohuar faktin që i atribuohet...;
- ii. se subjekti e ka cilësuar veprën penale të rrezikshmërisë shoqërore të lartë; *si dhe*
- iii. është shprehur se në caktimin e llojit dhe masës së dënimit për këtë të pandehur duhet të mbahet parasysh, rrezikshmëria e autorit të veprës penale e cila paraqitet relativisht e lartë;
- iv. nga ana tjetër, ka kërkuar aplikimin e “Rrethanave lehtësuese”⁵.

2.4 Mbi konstatimet e Komisionit në këtë çështje, pas kalimit të barrës së provës, por edhe në seancën dëgjimore, subjekti deklaroi se: i) kishte deleguar veprimet hetimore të mundshme për t’u realizuar; dhe se, ii) mundësitë për të gjetur mjetin ishin shumë të pakta.

Subjekti në konkluzionet përfundimtare ishte shprehur se, “... *gjykata duhet të mbajë parasysh qëndrimin e të pandehurit përpara, gjatë, dhe pas.....,të mbahej parasysh edhe fakti që ky person ka qenë i padënuar më parë, ... të mbahej në vëmendje se ky person paraqet rrezikshmëri të lartë*”. Neni 48 është i lidhur ngushtësisht edhe me nenin 49 të Kodit Penal.

2.5 Trupi gjykues, në analizë të veprimeve hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit në fashikullin penal, si dhe pas qëndrimit të tij, konstaton se:

- i. Subjekti nuk ka ndërmarrë veprime hetimore lidhur me veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve të ftohta”, sikurse nuk rezulton të jetë administruar ndonjë akt i tillë në fashikullin penal.
- ii. Pretendimet dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti bazohen kryesisht në hamendësime dhe jo në veprime konkrete hetimore, duke bërë kështu përpjekje për të zhvendosur

⁵ Neni 48; Rrethanat lehtësuese; Lehtësojnë dënimin rrethanat që vijnë:

a) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive me vlera pozitive morale e shoqërore; b) kur vepra është kryer nën ndikimin e tronditjes psikike të shkaktuar nga provokimi ose veprime të padrejta të viktimës apo të ndonjë personi tjetër; c) kur vepra është kryer nën ndikimin e veprimeve apo të udhëzimeve të padrejta të eprorit; ç) kur personi që ka kryer veprën tregon pendim të thellë; d) kur personi ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga vepra penale ose ka ndihmuar aktivisht për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale; dh) kur personi paraqitet në organet kompetente pas kryerjes së veprës penale; e) kur marrëdhëniet ndërmjet personit që ka kryer veprën penale dhe të dëmtuarit janë normalizuar. Rrethana lehtësuese e parashikuar në shkronjën “a” të paragrafit të parë të këtij neni, nuk lehtëson dënimin kur vepra penale është kryer në rrethanat e parashikuara në shkronjën “j” të nenit 50 të këtij kodi. Rrethana lehtësuese, e parashikuar në shkronjën “e” të paragrafit të parë të këtij neni, nuk lehtëson dënimin e një personi që ka kryer një vepër penale ndaj fëmijëve apo një vepër penale të dhunës në familje.

mungesën e kryerjes së tyre, me faktin se ato janë pasqyruar në relacionin përfundimtar të OPGJ-së.

- iii. Në analizim të diskutimeve përfundimtare të subjektit të rivlerësimit konstatohet se, qëndrimi i tij, ku nga njëra anë rendit rrethana që rëndojnë pozitën e të pandehurit, nga ana tjetër i sjell në vëmendje gjykatës zbatimin e nenit 48 të Kodit Penal, mbi aplikimin e rrethanave lehtësuese, bie ndesh me rolin dhe funksionin e tij si përfaqësues i organit të akuzës.
- iv. Pretendimi i subjektit se, neni 48 i Kodit Penal është i lidhur ngushtësisht me nenin 49 të këtij kodi, e çon subjektin në aplikimin e kushteve të lehtësimit të dënimit për të akuzuarin, pasi sikurse është lehtësisht e verifikueshme, neni 49 i Kodit Penal është atribut i vetëm i organit gjyqësor.

Në përfundim, trupi gjykues, çmon se:

- ✓ Konstatimet mbi dosjen penale të dyshuar për veprime korruptive, siç rezulton nga qëndrimi i subjektit në përfaqësimin e akuzës, lidhur me dënimin e pandehurit, mbështesin konstatimet e DSIK-së në raportin e tij, mbi favorizim kundrejt shumave të caktuara parash gjatë kohës në të cilën ka ushtruar detyrën e tij si prokuror.

INFORMACIONET E KLASIFIKUARA

2.6 Përveç hetimit të dy dosjeve penale nga të cilat DSIK-ja kishte informacione për veprime korruptive, me qëllim krijimin e bindjes së brendshme, anëtarët e trupit gjykues, gjithashtu verifikuan së bashku me vëzhguesin ndërkombëtar informacionet e klasifikuara, në bazë të të cilave janë përpiluar raportet e DSIK-së, informacione të cilat nuk mund t'i vihen në dispozicion subjektit, pasi janë të klasifikuara.

2.7 Në bazë të hetimeve të kryera nga Komisioni, përfshirë këtu edhe studimin dhe verifikimin e dokumenteve të klasifikuara, trupi gjykues, arrin në përfundimin se, përgjithësisht faktet e përmendura në raportet e DSIK-së, rezultojnë të lidhura dhe të mbështetura nga të dhëna të besueshme.

2.8 Në lidhje me veçantinë e krijimit të bindjes së brendshme nga ana e trupit gjykues në fazën e kontrollit të figurës, vlen për t'u theksuar se në këtë rivlerësim ka një specifikë që lidhet me njohjen dhe përdorueshmërinë e kufizuar të informacioneve të klasifikuara. Ky informacion ose dokumentacion nuk mund të përdoret në aktet publike apo të vihet në dispozicion të subjektit të rivlerësimit, me përjashtim të pjesëve të deklasifikuara. Për sa kohë është ligjësuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila në vendimin e datës 19.09.2017, është shprehur në çështjen me nr. 35289/11, - Ragner c/ Republikës Çeke⁶.

⁶ "...gjykatat kanë qasje të pakufizuar në të gjitha dokumentet e klasifikuara në të cilat Autoriteti është bazuar vetë në mënyrë që të justifikojë vendimin e tij. Ato kanë edhe autoritetin për të kryer një shqyrtim të hollësishëm të arsyeve të mbështetura nga Autoriteti për moszbulimin e dokumenteve të klasifikuara. Ata mund të vlerësojnë arsyet e dhëna për moszbulimin e dokumenteve të klasifikuara dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të atyre që konsiderojnë se nuk e garantojnë atë klasifikim", ".....e drejta për zbulimin e provave përkatëse nuk është një e drejtë absolute. Në çështjen penale ka gjetur se mund të ketë interesa konkurruese, siç është siguria kombëtare ose nevoja për të mbrojtur dëshmitarët në rrezik të hakmarrjes ose të mbajë sekret metodat e policisë për hetimin e krimin, të cilat duhet të vlerësohen kundrejt të drejtave të palës në gjykim....", ".... Në rastet kur provat nuk i janë vënë në dispozicion kërkuesit për arsye të interesit publik, gjykata duhet të shqyrtojë procedurën e vendimmarrjes për të siguruar që, për aq sa është e mundur, t'i përmbahet kërkesave për të siguruar parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve dhe të ofrojë garanci të përshtatshme për të mbrojtur interesat e personit në fjalë..."

“... Dhoma konkludoi se arsyet për vendimin e mospasjes akses (moszbulimit) të dokumentit në fjalë nga ana e kërkuarit ishin bazuar në interesa të sigurisë kombëtare, sepse sipas autoriteteve, zbulimi mund të kishte pasur efektin e zbulimit të metodave të punës të shërbimit të inteligjencës dhe burimet e tij të informacionit ose mund të çonin në përpjekjet e kërkuarit për të ndikuar mbi dëshmitarët e mundshëm. Sipas Dhomës, procedura e vendimmarrjes plotësonte “aq sa ishte e mundur” kërkesat e procesit të drejtë, dhe me ballafaqim, dhe barazisë së armëve në proces dhe përfshinte mbrojtje të përshtatshme të të drejtave dhe interesave të aplikantit, dhe kështu nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 i Konventës”.

- Për sa më sipër arsyetuar, në analizim të fakteve dhe rrethanave, trupi gjyqës çmon se:

- ✓ Konstatimet mbi dosjet penale të dyshuara për veprime korruptive, siç janë mosndërmarrja nga subjekti i rivlerësimit i veprimeve hetimore të plota për qartësimin e rrethanave të aktit korruptiv, si dhe qëndrimi i tij në përfaqësimin e akuzës, lidhur me dënimin e pandehurit në rastin e çështjes që i përket fashikullit penal të hetuar në Shkodër, mbështesin konstatimet e DSIK-së në raportin e tij, mbi favorizim kundrejt shumave të caktuara parash gjatë kohës në të cilën ka ushtruar detyrën e tij si prokuror.
- ✓ Raporti i DSIK-së, pasqyron rrethana që lidhen drejtpërdrejt me veprimet dhe mosveprimet e dyshuara të vetë subjektit të rivlerësimit, të cilat Komisioni i vlerësoi ato në raport me hetimin e dosjeve penale.
- ✓ Qëllimi dhe fryma e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me kontrollin e figurës, kërkon që procesi i rivlerësimit të identifikojë gjyqtarët e prokurorët, të cilët kanë integritet të cënuar, duke i përjashtuar ata nga sistemi i drejtësisë. Në këtë kuptim ky ligj, nuk synon vetëm verifikimin, nëse subjektet kanë kontakte të papërshtatshme, por edhe verifikimin e figurës së vetë subjektit, nëse ka dyshime të bazuara se ai është përfshirë në krimin e organizuar, sipas pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, konkretisht në veprime korruptive.
- ✓ Në vlerësimin tërësor të çështjes, bazuar në nenin 38/1, dhe 39 të ligjit nr. 84/2016, në analizën e të dhënave dhe **informacioneve të disponueshme**, provueshmërinë e saktë të **informacioneve konfidenciale** në lidhje me kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, veprimtaria korruptive e subjektit të rivlerësimit cënon drejtpërdrejtë pastërtinë e figurës së tij dhe për pasojë, subjekti ka cënuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

B. KRITERI I PASURISË

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për dosjen nr. (***), me shkresën nr. (***), datë 13.02.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personin e lidhur për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Gjithashtu, në referencë të nenit 32/5⁷ të ligjit nr. 84/2016, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, z. Fatmir Lushi, është bërë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së në vitin 2008, me numër indeksi (***).

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Hetimi administrativ, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, i ligjit nr. 84/2016.

Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën “Vetting”, sipas formularit (shtojca 2), datë 25.01.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016:

1. Mbi deklarinimin në lidhje me pasurinë, apartament, ndodhur në, Elbasan, me nr. pasurie (***), zk (***), vol. (***), fq. (***), me sip. 102.94 m², me adresë: Lagjja "(***)", Rr. “(***)", pallati (***), shk. (***), k. (***), ap. (***), përfituar me kontratë shitblerje nr. (***), datë 26.08.2013, e lidhur përpara noteres A. L., midis palës shitëse A. Q. dhe T. Q., si dhe blerësve Fatmir Lushi dhe M. L. . Kjo pasuri është blerë⁸ në bashkëpronësi, në pjesë të barabarta me babain e subjektit, z. M. L., në vlerën 5.056.412 lekë. Burim krijimi për pjesën në pronësi të subjektit: kursimet nga të ardhurat nga paga si prokuror, paga e bashkëjetueses si mësuese dhe për pjesën në pronësi të z. M. L., si person tjetër i lidhur, ka depozituar disa dokumente. Pjesa zotëruese: 50 %.

1.1 ILDKPKI-ja, në raporti e përcjellë është shprehur: “Referuar deklaratave të interesave private të dorëzuara ndër vite rezulton:

- ❖ Në deklaratën e interesave private “Periodik Vjetor 2013” subjekti ka deklaruar, apartament banimi në Elbasan, me sip. 102.94 m², me vlerë 5.056.412 lekë. Konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e apartamentit me sip. 102.94 m², në vlerën 5.056.412 lekë.
- ❖ Subjekti në asnjë nga deklaratat e interesave private, për periudhën Para Fillimit 2008 - Periodik Vjetor 2012, nuk ka deklaruar kursime të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e ½ pjesë të apartamentit me vlerë totale 5.056.412 lekë.”

1.2 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

Rezulton se, në deklaratën periodike për vitin 2013, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të saj.

⁷Deklarimet e interesave privatë dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelitimit.

⁸ Referojuni certifikatës së pasurisë në emër të Fatmir Lushi, M. L. dhe Q. L., lëshuar më datë 3.9.2013, në dosjen e ILDKPKI-së.

Rezulton se ZVRPP-ja Elbasan, me shkresën nr. (***) prot., datë 15.05.2018, ka konfirmuar se në emër të shtetasve Fatmir Lushit, M. L. dhe Q. L., figuron pasuria me nr. pasurie (***), zk(***), vol. (***), fq. (***), me sip. 102.94 m².

Sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, pasuria përshkruhet, apartament, me nr. (***), datë 26.08.2013, me palë blerëse, Fatmir Lushi dhe M. L. .

Mbi këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit, deklaroi pranë Komisionit, më datë 18.12.2018, mbi vlerën e investuar prej tij, dhe babait të tij, në shumën 5.056.412 lekë, në bashkëpronësi me investim në pjesë të barabarta.

1.3 Komisioni, hetoi mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të krijuara nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie.

1.4 Nga aktet e administruara në dosjen e ILDKPKI-së, rezulton se subjekti nuk kishte deklaruar në deklaratën e interesave privatë "Periodik Vjetor 2013" burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e apartamentit në Elbasan, në vlerën 5.056.412 lekë, si dhe nuk kishte deklaruar në deklaratat e interesave private për periudhën "Para Fillimit 2008" - "Periodik vjetor 2012" kursime *cash*, të cilat subjekti i deklaroi si burim për blerjen e 1/2 pjesë të apartamentit.

1.5 Mbi këtë konstatim të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera deklaroi⁹ se:

1.5.1 Për blerjen e 1/2 (*një e dyta*) të apartamentit kishin shërbyer kursimet ndër vite, të ardhurat nga paga tij, që nga tetori i vitit 2006 (dy vitet e para të Shkollës së Magjistraturës- bursa), si dhe nga kursimet ndër vite, të ardhurat e pagës së bashkëjetueses, që nga viti 2011. Të ardhura të cilat kishin qenë burimi i vetëm i të ardhurave për familjen tij.

1.5.2 Mosdeklarimin e gjendjes *cash*, e kishte vlerësuar se llogaritej nga ILDKPKI-ja, si dhe shuma e parave e përdorur për blerjen e 1/2 (një të dytën) së apartamentit në vitin 2013, ishte ruajtur në banesë *cash*.

1.5.3 Kontributi i bashkëjetueses, përbëhej nga kursime të pagës së saj për vitet 2011 - 2012 dhe 2013, për të cilën nuk mund të përcaktonte një vlerë të caktuar të këtij kontributi, pasi mbanin një ekonomi të përbashkët.

1.6 Komisioni, gjatë hetimit administrativ konstatoi se, nga deklaratat periodike kishte paqartësi në lidhje me gjendjen e likuiditeteve *cash* dhe si rrjedhojë i kërkoi subjektit të rivlerësimit të deklaronte gjendjen në fund të çdo viti kalendarik, për sa i përkiste likuiditeteve në të holla *cash*, si dhe në bankë për periudhën e deklarimit (2003 - 2016), duke përfshirë në këtë deklaram edhe personat e lidhur.

1.7 Mbi paqartësitë e situatës së likuiditeteve, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera deklaroi se: "...për periudhën 2003 - tetor 2006, të ardhurat që ishin siguruar nga puna e tij ishin bërë pjesë e të ardhurave të familjes së origjinës. Shuma totale e kursimeve të tij dhe bashkëjetueses nga tetori i vitit 2006 deri në dhjetor të vitit 2013 (sipas përlllogaritjeve të tij ishin afërsisht në vlerën 3.127.256 lekë)", me të cilat pretendon se ka mbuluar blerjen e pasurive si dhe shpenzimet për arredimin e apartamentit.

1.8 Komisioni kreu analizën financiare për burimet e ligjshme të përdorura prej subjektit në masën 50 % për blerjen e pasurisë apartament, në vitin 2013, sipas tabelës së mëposhtme.

⁹ Refero shkresën nr. (***) prot., datë 04.10.2018, në dosjen e Komisionit.

Analiza financiare për vitin 2013

Vlera në LEK

| | |
|---|--------------------|
| Të ardhura nga pagat (subjekti + b/jetuesja) | 1.307.365 |
| Totali i mjeteve monetare të hyra | 1.307.365 |
| Pagesat për shpenzime jetese | 433.072 |
| Shpenzime transporti | 132.475 |
| Shpenzime arredimi | 222.500 |
| Totali i shpenzimeve | 778.047 |
| Ndryshim i mjete monetare 01.01.2013 – 31.12.2013 | - 174.994 |
| Mjete monetare të disponueshme (1) | 704.312 |
| Blerje apartamenti (2) | 2.528.206 |
| Balanca e fondeve (1-2) | - 1.823.893 |

1.9 Nga analiza e fakteve të sipërpërmendura, Komisionit i rezultoi dhe për pasojë i kaloi barrën e provës subjektit, pasi dukej se: i) subjekti nuk kishte pasur burime të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie në masën 50 %; ii) nuk kishte deklaruar në deklaratën për vitin 2013, burimin e krijimit të të ardhurave nga ana e tij dhe babait të tij; si dhe iii) kishte vepruar në kundërshtim me shkronjën “d”, të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, pasi nuk kishte deklaruar gjendjen *cash* prej deklarimit për herë të parë në vitin 2008.

1.10 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni:

1.10.1 Subjekti në parashtrimet e tij, por edhe në seancën dëgjimore, ka deklaruar se përveç të ardhurave të tij dhe të bashkëjetueses nuk kishte pasur të ardhura të tjera. Në vitin kur kishte deklaruar pasurinë, apartament, nuk kishte asnjë lloj burimi tjetër, por duke deklaruar pagat dhe pasurinë kishte menduar se kishte përmbushur detyrimin ligjor. Në vitin 2014, kur ligji për deklarimin pasurive pësoi ndryshime, subjekti kishte nisur deklarimin e gjendjes *cash*. Në vitet 2009, 2010, pretendonte se kishte pasur në llogarinë e pagës likuiditete të patërhequra në fund të muajit dhjetor, të cilat ishin të verifikueshme.

1.10.2 Subjekti ka depozituar raportin e auditit ligjor, i cili sipas tij tregon se kishte pasur burime të ligjshme për të mbuluar pasuritë në raport me të ardhurat, pasuritë, shpenzimet, me një nivel jetese në standard minimal. Në vitin 2009, nuk i kishte deklaruar si likuiditete, por pretendonte se këtë fakt e pasqyron *statementi* i bankës. Në vitin 2013 ishte blerë apartamenti dhe çfarë kishte mbetur në fund të vitit i kishte deklaruar në vitin 2014.

1.11 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.11.1 Trupi gjykues, në analizim të fakteve dhe provave, rezulton se pasuria është deklaruar në deklaratën “Vetting”, me burim, kursime ndër vite, “*cash në banesë dhe bankë*”, ndërsa si pasuri është blerë në vitin 2013, vit në të cilin subjekti nuk e ka deklaruar burimin e krijimit.

1.11.2 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në asnjë prej deklaratave periodike deri në vitin 2014, kursime *cash* në banesë, si burim i pretenduar për krijimin e kësaj pasurie. Rezulton se të ardhurat e subjektit dhe bashkëjetueses ishin vetëm të ardhura nga pagat. Subjekti i rivlerësimit, për të provuar se kishte mundësi për të kursyer me qëllim blerjen e kësaj pasurie, paraqiti raportin e auditit¹⁰ që prej muajit tetor 2006 e në vijim.

1.11.3 Nga analiza e raportit të auditit, rezulton se audituesi ka ndjekur të njëjtën metodologji si Komisioni në përlogaritjen e të ardhurave, për shpenzimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij, për të dhënë rezultatet e kursimeve të mundshme që kjo familje mund të kishte në fund të çdo viti kalendarik. Në dallim nga Komisioni, audituesi ka marrë të mirëqenë faktin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të krijojë gjendjen *cash* pavarësisht faktit të mosdeklarimit në deklaratat periodike.

1.11.4 Trupi gjykues konstaton se, sipas analizës financiare të kryer nga audituesi ligjor, rezulton që në fund të vitit 2008, subjekti duhet të kishte shumën prej 715.306 lekësh gjendje *cash*. Në këtë analizë gjendja *cash* rritet vazhdimisht, madje me shuma të konsiderueshme, gjë që nuk rezulton të jetë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në asnjë deklaratë.

1.11.5 Mbi pretendimin e subjektit se ai ka pasur likuiditete në fund të viteve në sistemin bankar, pavarësisht vlerave të tyre, të krijuara nga pagat e tij dhe bashkëjetueses, trupit gjykues i rezulton se, ky deklaram nuk përputhet me gjendjen faktike të pasqyruar në dokumentet bankare, prova të administruara në dosje.

1.11.6 Gjithashtu, mbi këtë pretendim të subjektit, Komisionit i rezulton se, në analizën e tij financiare, ka përfshirë të gjitha likuiditetet në sistemin bankar për periudhën 2008 - 2016, por edhe pasi riverifikoi gjendjen e tyre në fund të çdo viti deri në blerjen e pasurisë, situata financiare pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.

Pasqyra e gjendjes bankare për vitet 2008 - 2016

| Vitet | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|---|-------|---------|---------|--------|---------|--------|---------|---------|-----------|
| Gjendja bankare në fund të vitit (subjekti + bashkëjetuesja + depozita) | 2 318 | 119 647 | 450 834 | 47 742 | 224 770 | 49 776 | 217 793 | 345 944 | 1 751 842 |

1.11.7 Ndërkohë, Komisioni, nisur nga situata financiare e paraqitur në raportin e auditit për vitin 2014, vit në të cilin pretendohet nga subjekti se janë sistemuar pasaktësitë për gjendjen e *cash*-it, arrin në konkluzion se, subjekti bën përpjekje të vazhdueshme për të rregulluar situatën financiare, pasi:

- ¹⁰ Licencën e lëshuar nga IEKA-ja, me Vendimin e Komitetit të regjistrimit nr. (***) , datë 31.01.2000, në emër të shtetasit A. Q. për të ushtruar profesionin e audituesit ligjor;
- Certifikatën e regjistrimit si person fizik të audituesit në të cilën identifikohet NUIS i tij; si dhe,
- Faturën tatimore mbi kryerjen e këtij raporti auditimi.

- ✓ Sipas analizës së audituesit, *cash*-i, në këtë vitin 2014, pasqyrohet i përlogaritur në vlerën 2.515.559 lekë, ndërkohë që në deklaratën periodike të këtij viti, rezulton se subjekti ka deklaruar vetëm vlerën prej 800.000 mijë lekësh gjendje *cash*.
- ✓ Pra, rezultojnë dy vlera kontradiktore të pasqyruara nga vetë subjekti, për të njëjtin vit që, nëse do të merren të mirëqena pretendimet e tij për gjendjen e *cash*-it, të paraqitura në raportin e audituesit, atëherë subjekti në vitin 2014, vendoset në kushtet e kryerjes së deklaramit të rremë dhe njëkohësisht të fshehjes së këtij likuiditeti.

1.18. Fakti që subjekti pretendon se ka rregulluar deklaramet në vitin 2014, për shkak se në atë vit është qartësuar koncepti ligjor për të deklaruar gjendjen *cash*, nuk qëndron, për arsye se, fryma e ligjit specifik nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar, prej miratimit dhe hyrjes në fuqi të tij, ka parashikuar se, detyrimi ligjor i subjekteve deklarues për deklaramin e vlerës së likuiditeteve, gjendjes në *cash*, etj, nis para fillimit të detyrës, si dhe çdo vit, me ndryshimet e ndodhura deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës. Sipas kësaj dispozite, subjekti duhej të deklaronte vit pas viti gjendjen e likuiditeteve në *cash*, për më tepër që subjekti i rivlerësimit këtë gjendje e pretendon si burim krijimi të pasurisë.

1.19 Në lidhje me burimin e të ardhurave të babait të subjektit për pagesën e 50 % të vlerës së apartamentit.

1.20. Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

1.20.1 Rezulton se, në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit si burim krijimi për pjesën në pronësi të babait të tij, si person tjetër i lidhur, ka depozituar vetëm disa dokumente¹¹, ndërkohë që në deklaratën periodike nuk e ka deklaruar burimin e krijimit.

1.20.2 Subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklaramet në lidhje me burimin e të ardhurave të babait të tij, duke e shoqëruar atë me deklarata noteriale¹² të familjarëve të tij gjatë hetimit administrativ.

1.20.3 Nga aktet e administruara, Komisionit i rezulton se, Dega e Arkivit¹³ Tiranë, ka informuar se nuk administron dokumentacion për të vetëpunësuarit në bujqësi për Drejtorinë e Sigurimeve Shoqërore Elbasan, nga periudha 1994 e në vazhdim.

1.20.4 Lidhur me provueshmërinë e punësimit të prindërve të tij, subjekti ka vënë në dispozicion dokumentacion shtesë¹⁴, nga ku rezulton se:

¹¹ Referojuni deklaratës me shkrim në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit në bashkëpronësi me Fatmir Lushin. Kësaj deklarate me shkrim i ka bashkëlidhur vërtetime të Njësisë Administrative F. Elbasan, për pagën si mësues të Fatmir Lushi (djali) dhe pagë si infermiere të D. L. (Vajza). I ka bashkëlidhur vërtetime të DRSSH Elbasan, së bashku me kopje aktesh, për M. L. dhe Q. L. si dhe Vërtetim të lëshuar nga DAMT Elbasan për trajtimin me tokë bujqësore.

¹² Deklaratë noteriale e shtetasit Q. L., nr. (***), datë 29.09.2018. Deklaratë noteriale e shtetasit H. L., nr. (***), datë 28.09.2018. Deklaratë noteriale e shtetasit D. Ç. (L.), nr. (***), datë 28.09.2018. Deklaratë noteriale e shtetasit B. L., nr. (***), datë 29.09.2018. Deklaratë noteriale e shtetasit A. A., nr. (***), datë 29.09.2018. Deklaratë noteriale e shtetasit F. Sh., nr(***), datë 30.09.2018, ekstrakt regjistri QKB, së bashku me dokument identifikues, gjithsej 5 (pesë) fletë; Deklaratë personale e shtetasit Xh. D., më datë 28.09.2018.

¹³ Referojuni shkresës nr. (***), prot., datë 17.01.2019, në dosjen e Komisionit.

¹⁴ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit të datës 26.09.2018, dërguar pranë Komisionit, më datë 23.11.2018.

- Babai i subjektit, (i ndjeri) M. L. (si person tjetër i lidhur), ka bërë një deklaratë me shkrim në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit në bashkëpronësi me Fatmir Lushin. Kësaj deklarate me shkrim i ka bashkangjitur vërtetim të Njesisë Administrative F., për pagën si mësues të z. Fatmir Lushi (djali) dhe pagën si infermiere të D. L. (vajza); vërtetime të DRSSH-së Elbasan, së bashku me kopje aktesh për M. L. dhe Q. L., si dhe vërtetim të lëshuar nga DAMT-ja Elbasan për trajtimin me tokë bujqësore.

1.20.5 Komisioni kreu analizën financiare deri në muajin gusht 2013, lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave të familjes së origjinës¹⁵, për blerjen e pasurisë në masën 50 %. Përlllogaritja e të ardhurave u bë mbi bazë të deklarimeve të subjektit, sipas përgjigjeve të pyetësorit, datë 4.10.2018, dhe datë 28.12.2018, ku citohet se:

- Paga e subjektit deri, më datë 01.10.2006, është dorëzuar te babai;
- Motra e subjektit para martesë dorëzonte pagën te babai;
- Bazuar në aktet e administruara në dosje, rezulton se, babai i subjektit ka nisur të përfitojë pension pleqërie prej muajit gusht 2012.

1.20.6 Rezulton se, për periudhën përpara daljes në pension të prindërve të subjektit, si edhe për dy vëllezërit e tij, shpjegimet e subjektit kanë konsistuar vetëm në pasqyrimin se si janë përfituar të ardhurat nga shitja e produkteve bujqësore dhe blegtorale, por në asnjë rast nuk janë deklaruar të ardhurat e përfituara në vlerë monetare.

Analiza financiare për vitin 2013

| Familja e origjinës | Vlera në LEK |
|--|---------------------|
| Babai M. L.i (të ardhura nga pensioni) | 167.648 |
| Subjekti i rivlerësimit (deri në Tetor 2006) | 824.976 |
| Motra, D. L. (martuar Tetor 2006) | 318.640 |
| Vëllai, H. L. (martuar 2009) | nuk ka të dhëna |
| Vëllai, B. L. | nuk ka të dhëna |
| Totali | 1.311.264 |

- ✓ Nga analiza e fakteve të sipërpërmendura, Komisionit i rezultoi dhe për pasojë i kaloi barrën e provës subjektit, se të ardhurat e matshme të familjes së origjinës së subjektit të rivlerësimit, pa konsideruar shpenzimet e jetesës, nuk kanë qenë të mjaftueshme për të mbuluar pagesën në vlerën prej 2,5 milion lekësh.

¹⁵Vërtetim pensioni, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, për z. M. L., nr. (***) prot., datë 06.11.2018.
 Vërtetim pensioni, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, për znj. Q. L., nr. (***) prot., datë 06.11.2018.
 Vërtetim i Drejtorisë Arsimore Rajonale Elbasan, nr. (***) prot., datë 22.10.2018.
 Vërtetim i Njesisë Administrative F., nr. (***) prot., datë 21.11.2018.
 Fotokopje e urdhrit të prokurimit nr. (***), datë 15.08.1996, shoqëruar me preventiv.

1.21 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni:

Në parashtrimet e tij subjekti ka sqaruar se, prindërit e tij kanë përfituar të ardhura nga bujqësia, blegtoria, pemëtaria, etj. dhe se kanë qenë të përjashtuar nga detyrimet tatimore. Njëkohësisht, subjekti ka evidentuar edhe faktin se prindërit e tij kanë qenë të siguruar në kategorinë e të vetëpunësuarit në bujqësi, dhe se ka paguar rregullisht taksën e tokës, ka provuar sasinë e bagëtive të imta dhe gjedhit, sasinë e tokës, të ardhurat nga pemët frutore, të ardhurat nga mbledhja e bimëve mjekësore. Subjekti ka sqaruar se të ardhurat që prodhohen në familjen bujqësore rimbursohen dhe jo taten. Ndërsa, sa i përket të ardhurave të përfituara nga punësimet në shoqëritë private, subjekti ka sqaruar se detyrimi ka qenë i shoqërive private. Për të provuar se prindërit kanë pasur burime të mjaftueshme për blerjen e pasurisë në shumën 50%, subjekti ka kërkuar t'i llogariten të ardhurat e pasqyruara në raportin e auditit, duke vënë në dispozicion disa deklarata noteriale për të provuar punësimin e babait dhe vëllezërve të tij, sipas të dhënave të pasqyruara në raportin të auditit.

1.22 Arsytimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Komisioni, në analizë të parashtrimeve dhe provave të depozituara, vlerëson se, për sa i përket të ardhurave nga punë të ndryshme sezonale të babait dhe vëllezërve të subjektit në sektorin privat, si ndërtim urash, rrugë dhe shkolla, subjekti nuk provoi me asnjë dokumentacion ligjor, të tilla si, kontratë punë, listëpagesa, etj., dhe për rrjedhojë, nuk provoi burimin e ligjshëm të të ardhurave. Në këtë drejtim, parashtrimet e subjektit mbetën në nivel deklarativ.

1.23 Komisioni, mbi krijimin e të ardhurave në nivel blegtoral, bujqësor, apo dhe shitja e bimëve mjekësore, sipas raportit të auditit, konstaton se:

- Auditit ka kryer analizën me të gjitha të ardhurat nga bujqësia, blegtoria, bimët mjekësore dhe punësimet, por nuk ka përfshirë shpenzimet e kryera në raport me këto të ardhura, të tilla si mirëmbajtja, ushqimi i bagëtisë, kujdesi veterinar, përdorimi i mjeteve për punimin e tokës, konsumi i plehrave kimikë, etj.

- Komisioni vëren se edhe analiza e auditit në këto përlllogaritje mbetet në nivel deklarativ. Kjo konfirmohet edhe për faktin se nga studimi i analizës në këtë raport rezulton se audituesi merr të mirëqenë të ardhurat e përfituara për çdo vit në mënyrë të barabartë duke mos marrë në konsideratë në asnjë rast kushtet e motit (p.sh. thatësinë) dhe për pasojë edhe prodhimtarinë e cila nuk mund të jetë e njëjtë.

Gjithashtu, Komisioni vëren se, analiza e audituesit në këto përlllogaritje nuk merr në konsideratë faktin që, pas vitit 1991, ka ndodhur ndryshimi i kursit dhe vlerës së monedhës shqiptare dhe se inflacioni i atyre viteve ishte rreth 15.8 %, çka do të thotë se niveli i përgjithshëm i çmimeve të konsumit në ekonomi u rrit me 15.8 % në krahasim me vitin e kaluar^[1], situatë kjo që ka vazhduar deri rreth vitit 1998. Kjo tregon se, me kursimet që mund të kishte krijuar çdo shtetas, nuk mund të investonte për të blerë një pasuri¹⁶. Për rrjedhojë, analiza e bërë në raportin e auditit mbi mundësinë e krijimit të kursimeve për këtë periudhë kohore nuk pasqyron situatën reale ekonomike të atyre viteve dhe për pasojë nuk është bindëse.

[1] https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Të_flasim_thjesht_për_inflacionin_3383_1_6878.pdf

¹⁶ Në publikimin e Bankës së Shqipërisë mbi ndryshimin e vlerës së parasë në Shqipëri, vërehet se paraja kishte humbur rreth 18 herë vlerën e saj që nga dhjetori i vitit 1991, psh., për të blerë të njëjtën sasi malli, në vend të shumës prej 100 lekë që nevojitej 10 vjet më pare, tashmë duheshin 1000 lekë.

1.24 Komisioni, hetoi në lidhje me shpenzimet për arredimin e këtij apartamenti duke u bazuar në deklaratimet e subjektit, në pyetësorin standard, ku vlera e arredimit deklarohet afërsisht 1.400.000 (një milion e katërqind mijë) lekë, të investuar në pjesë të barabarta, nga të ardhurat e familjes së tij dhe të babait.

1.24.1 Në këto përlllogaritje, Komisioni, administroi në cilësinë e provës procesverbalin e datës 18 shkurt 2016, mbajtur pranë ILDKPKI-së, nga ku subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Vlera mesatare e shpenzuar për mobilim është rreth 300.000 lekë për dy vitet 2013, 2014”*.

1.24.2 Komisioni, për të arritur në një konkluzion objektiv lidhur me mundësinë e krijimit të të ardhurave për arredimin e këtij apartamenti, i ka kërkuar subjektit¹⁷ të japë shpjegime në nivel provueshmërie, për të cilën subjekti deklaroi vlerat e shpenzuara në vitet përkatëse.

1.24.3 Sipas analizës financiare në tabelën nr. 1, rezulton se, subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme edhe për të përballuar 50 % të vlerës së arredimit të shtëpisë në këto vite, sikurse ka deklaruar.

- ✓ Bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, si dhe shqyrtimit të rrethanave në tërësi, trupi gjykues, arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, referuar paragrafit 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi:
 - i. nuk ka deklaruar gjendjen *“cash”* në deklaratimet periodike, si burim krijimi i kësaj pasurie;
 - ii. bazuar në analizën financiare, ka mungesë të të ardhurave për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie të deklaruar në deklaratën *“Vetting”*, si dhe për të përballuar shpenzimet e kryera për arredim;
 - iii. analiza financiare në raportin e audituesit, kryesisht është realizuar në nivel deklarativ.
- ✓ Për sa më sipër, në vlerësimin e fakteve dhe rrethanave në tërësi, trupi gjykues çmon se, ato nuk janë bindëse, pasi në asnjë rast subjekti nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ.

2. Në lidhje me mosdeklarimin e pasurisë në përdorim nga subjekti, në adresën e personit tjetër të lidhur, shtetasit R. Sh. .

2.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

2.1.1 Komisionit i rezultoi se, në deklaratat e interesave private periodike vjetore 2008 - 2012 të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, ka deklaruar si adresë banimi, në S., pranë Shkollës së Policisë.

2.1.2 Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së rezulton se, shtëpia me këtë adresë është në pronësi të dajës së subjektit, z. R. Sh., e përfutuar me leje legalizimi në vitin 2015.

2.1.3 Komisionit, i ka rezultuar se subjekti ka qenë titullar i kontratës së energjisë elektrike që prej vitit 2011 e në vijim dhe se e ka deklaruar si adresë banimi që prej vitit 2008.

2.1.4 Mbi këtë konstatim të Komisionit, subjekti ka deklaruar se, ka lidhur kontratë për furnizimin me energji elektrike për katin e parë në të cilin banonte në këtë periudhë për shkak

¹⁷ Referojuni pyetësorit, datë 18.12.2018, në dosjen e Komisionit.

të problemeve që kishte z. R. Sh.(daja i subjektit), me OSHEE-në, si dhe kishte paguar energjinë deri në tetor 2015.

2.1.5 Gjithashtu, Komisionit i ka rezultuar se, subjekti ka zgjidhur kontratën me OSHEE-në, vetëm pasi Komisioni e konstatoi këtë fakt dhe i kërkoi shpjegime gjatë hetimit administrativ.

2.1.6 Nga hetimi ka rezultuar se, subjekti nuk ka deklaruar përdorimin e kësaj pasurie për sa kohë ai ka deklaruar se e ka përdorur këtë banesë.

2.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni.

2.2.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, kishte banuar në atë banesë, por nuk e kishte pasur atë në përdorim vetjak, se banesa ishte përdorur gjatë gjithë kohës nga daja i subjektit dhe familjarët e tij dhe se ai kishte banuar si pjesëtar *de facto* në atë familje.

2.3 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.3.1 Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe rrethanave të lidhura me pranimin nga ana e subjektit se: i) ka përdorur këtë pasuri; ii) ka lidhur një kontratë energjie elektrike, për të cilin ka vazhduar të jetë titullar i saj deri në vitin 2018; iii) ka kryer pagesa të konsumit të energjisë elektrike, si dhe bazuar në vendimin nr. 17, datë 19.12.2001, të Këshillit Drejtues të ERE-s, “Mbi miratimin e udhëzimit mbi furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të rinj”, në të cilin konstatohet dhe çmohet se, përdorues të energjisë elektrike janë personat fizikë dhe juridikë, zotërues të objektit, ku janë vendosur pajisje që punojnë me energji elektrike dhe janë apo duan të lidhen në rrjetin elektrik,

✓ Çmon se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi¹⁸ në deklaram në lidhje me përdorimin e kësaj pasurie, fakt ky që bie ndesh me nenin D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

3. Mbi deklaramin në lidhje me pasurinë 2000 m², tokë Arë, në fshatin K., Njësia Administrative F., Elbasan, që rrjedh nga trajtimi me tokë i familjes bujqësore të z. M. M. L. (babai i subjektit), sipas ligjit nr. 7501/1991. Kjo pjesë është ideale, e zotëruar 100 %, e pandarë nga sipërfaqja totale prej 9.300 m² e familjes bujqësore¹⁹.

3.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

3.1.1 Rezulton se në deklaramin “Vetting” është deklaruar pasuria më sip. 2000 m² “Tokë arë”, fituar me ligjin nr. 7501/1991.

3.1.2 Për këtë pasuri ZVRPP-ja²⁰ Elbasan nuk ka dhënë informacion.

¹⁸ Referuar edhe vendimit nr. 12 datë 27.12.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

¹⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaramin kopje të AMTP-së, në emër të z. M. L., datë 24.3.1993 dhe vërtetim të lëshuar nga DAMT-ja Qarku Elbasan. Subjekti në këtë deklaramin të kësaj pasurie ka qartësuar se nuk ekziston ndonjë dokument që të ketë vlerësuar në vlerë në lekë tokën e fituar sipas ligjit nr. 7501/1991, në këtë fshat.

²⁰Referojuni shkresës nr. (***) prot, datë 15.05.2018, në dosjen e Komisionit.

3.1.3 Në deklaratën noteriale, datë 28.09.2018, znj. D. Ç.,²¹ ndër të tjera është shprehur se, regjistrimi i tokës së fituar nga familja bujqësore e z. M. L., nuk është regjistruar pranë ZVRPP-së Elbasan, pasi akoma nuk është bërë azhurnimi i tokës.

3.1.4 Këshilli i Qarkut²² Elbasan konfirmon se, qytetari M. M. L., rezulton të ketë përfituar në fshatin K., një sipërfaqe 9300 m², tokë bujqësore në pronësi të ndarë në katër parcela të ndryshme.

3.1.5 Prefekti i Qarkut²³ Elbasan informon se, nga kontrolli i kryer nuk rezulton të jetë kryer pranë Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë ndonjë kërkesë dhe as Komisioni Vendor nuk ka ushtruar kontroll me iniciativën e tij në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së AMTP-së, datë 24.03.1993, lëshuar nga Komisioni i ndarjes së tokës së fshatit K. në emër të shtetasit M. M. L. .

3.1.6 Bashkia²⁴ Elbasan, konfirmon ndër të tjera se sipas informacionit të dërguar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, z. M. M. L., rezulton të ketë përfituar në fshatin K., tokë bujqësore²⁵ në pronësi, me sipërfaqe 9300 m². Gjithashtu, me këtë shkresë Bashkia informon se, shtetasit M. L., Q. L. dhe Fatmir Lushi, janë shpërngulur nga fshati K. i Njësisë Administrative F., për qytetin e Elbasanit rreth muajit shtator 2013. Bashkia konfirmon se DAMTP-ja ka bërë me dije se toka bujqësore në fshatin K. është ndarë bazuar në ligjin nr. 7501/1991, dhe aktet e tokës janë plotësuar në emër të kryefamiljarit. Sipas formularit 6 që disponon kjo drejtori, në numrin rendor 78, shtetasi M. M. L., rezulton të ketë përfituar në fshatin K. tokë bujqësore në pronësi me sipërfaqe 9300 m², të ndarë në katër parcela të ndryshme.

3.2 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

- ✓ Lidhur me këtë pasuri, në rezultatet e hetimit, trupi gjykues, duke pasur parasysh faktet e dala, provat, si dhe ligjin e zbatueshëm, konkludoi se, deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në bazë të përgjigjeve të ardhura nga institucionet përkatëse.

4. Mbi deklarimin e pasurisë “Tokë arë”, me sipërfaqe 276 m², ndodhur në fshatin F., Tiranë, me nr. pasurie (*), zk (***), vol. (***), fq. (***), përfituar me kontratë shitblerje, nr. (***), datë**

²¹ Shih në dosjen e Komisionit pyetësorin e protokolluar pranë Institucionit tonë me shkresën nr. (***) prot., datë 04.10.2018.

²² Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 20.01.2018, në dosjen e Komisionit.

²³ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 20.11.2018, në dosjen e Komisionit.

²⁴ Referojuni shkresës nr(****), datë 13.12.2018, në dosjen e Komisionit.

²⁵ Fitimi i pronësisë mbi tokat bujqësore mund të realizohej vetëm në plotësim dhe zbatim të kriterëve të sanksionuara në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën” (i ndryshuar), ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore” dhe ligjit nr. 8337, datë 30.04.1998, “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre, përfshirë edhe VKM-të në zbatim të ligjit për shkrirjen e ndërmarrjeve bujqësore.

Në thelb të këtyre akteve qëndron interesi parësor i shtetit për të pajisur me tokë bujqësore:

1. Familjet bujqësore, që figurojnë si të tilla deri në datën 01.08.1991.

2. Në radhë të dytë, të pajisë me tokë personelin teknik dhe administrativ të NB-ve apo të kthejë pjesën e mbetur te personat që e kanë dorëzuar si kontribut në themelimin e kooperativave bujqësore apo NB – apo trashëgimtarëve të tyre (në kufijtë ekzistues – brenda mundësive).

Pra, kanë të drejtë që të pajisen me tokë bujqësore themeluesit e kooperativave bujqësore dhe të ndërmarrjeve bujqësore me banim në fshat deri në 01.08.1991; punonjësit e ndërmarrjeve bujqësore dhe punonjësit në shtet dhe që kanë banim në fshat deri në tetor të vitit 1992; si dhe në fund, toka që mbetet në dispozicion, u jepej ish-pronarëve, me tokat e të cilëve janë themeluar kooperativat dhe ndërmarrjet bujqësore deri në limitin e tokës së dhënë dhe, kur kjo nuk ishte e mundur, deri në limitin e sipërfaqes së tokës në dispozicion.

Kushti: Në referim të datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, përfitojnë nga ky ligj ato familje bujqësore që janë anëtare të kooperativës dhe banojnë në fshat të paktën deri më 01.08.1991.

06.10.2008, lidhur përpara noteres A. A., midis palës shitëse Xh. dhe B. Sh. dhe blerësit Fatmir Lushi²⁶, në vlerën 96.600 lekë.

Burim krijimi: *Kursime nga pagesa që bëhej gjatë ndjekjes së studimeve në Shkollën e Magjistraturës*. Pjesë zotëruese: 100 %.

4.1 ILDKPKI-ja, në raporti e përcjellë është shprehur: *“Vlera e blerjes së pasurisë “Tokës arë” me sip. 276 m², në shumën 96.600 lekë ose 350 lekë/m² është e dyshimtë për faktin se zona është në zhvillim dhe me kërkesa në rritje të vazhdueshme prej vitesh.”*

4.2 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

4.2.1 Në deklaratën periodike përpara fillimit të detyrës në vitin 2008, kur subjekti ishte prokuror në stazh, në stazhin e Durrësit, deklaroi në pronësi 276 m² tokë, në Komunën F., Tiranë, në vlerën 96.600 lekë, pa deklaruar burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie.

4.2.2 ZVRPP-ja²⁷ Tiranë konfirmon se, ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të z. Fatmir Lushi, pasurinë nr. (***), vol. (***) fq. 91, zk. (***), lloji i pasurisë, arë, me sipërfaqe 276 m².

4.2.3 Nisur nga konkluzioni i ILDKPKI-së për sa i përket dyshimit të shumës së paguar për këtë pasuri, ndërkohë që zona është në zhvillim dhe me kërkesa në rritje të vazhdueshme prej vitesh, ZVRPP²⁸-ja Tiranë informon se çmimi prej 350 lekësh/m² për tokën arë në F., në vitin 2008, referuar Vendimit Nr. 129, datë 13.02.2008, të Këshillit të Ministrave, është sipas çmimit të referencës.

4.2.4 ZVRPP-ja²⁹ Tiranë ka konfirmuar se, origjinë e pronës ka qenë AMTP-ja nr. (***), që i jep në pronësi, z. Xh. Sh., sip. 12.000 m².

4.2.5 Me pyetësin, datë 26.09.2018, Komisioni, ka pyetur subjektin e rivlerësimit në lidhje me origjinën e kësaj prone.

4.2.6 Në përgjigjen³⁰ e dhënë subjekti ka deklaruar se: *“... Për sa i përket origjinës së këtyre pronave, duke iu referuar dokumentacionit mbi bazën e të cilit është bërë hartimi i kontratës së shitjes dhe regjistrimi në ZVRPP-në Tiranë, këto sipërfaqe toke janë tokë arë, të cilën familja bujqësore me kryefamiljar, z. Xh. Sh., e ka fituar në bazë të AMTP-së me nr. (***), në fshatin F.”*.

4.2.7 Nga burime të hapura³¹ Komisionit i ka rezultuar se, për familjen me të njëjtin mbiemër me atë të shitësit (familja Sh.), ka një çështje në gjykim për një truall, të ndodhur në F., me objekt: *“1. Anullimin e plotë të aktit të marrjes së tokës bujqësore” me nr(***)*, datë 13.03.2002, me sipërfaqe totale prej 5000 m², nga ana e familjes bujqësore që përfaqësohet nga z. M. Sh., lëshuar nga komisioni i fshatit F., Njësia F. . 2. Kthimin në pronësinë e shtetit të

²⁶ Certifikata e pasurisë në emër të z. Fatmir Lushi, lëshuar, më datë 15.10.2008, në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁷ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 17.08.2018, në dosjen e Komisionit.

²⁸ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 16.08.2018, në dosjen e Komisionit.

²⁹ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 03.10.2018, në dosjen e Komisionit.

³⁰ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit, datë 04.10.2018, në dosjen e Komisionit.

³¹ Referuar rekomandimit të vëzhguesit ndërkombëtar, në dosjen e Komisionit.

sip. 3300 m², me të dhënat e mëposhtme: Pasuri nr. 506/6 (rreshti 1 në AMTP), regjistruar pranë ZVRPP Tiranë, vol. (***), fq. (***), zk (***), me sip. 3300 m². 3. Detyrimin e familjes bujqësore të paguajë vlerën e pasurisë së mëparshme me transaksion ndaj të tretit 1700 m² në shumën prej 761.600 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind) lekësh. 4. Shfuqizim i pjesshëm i AMTP-së, nr. (***), datë 10.06.1996, me sipërfaqe totale prej 4500 m², për familjen bujqësore të përfaqësuar nga z. M. Sh., lëshuar nga Komisioni i Tokave të F., Njësia Administrative F., për sipërfaqen prej 200 m².

4.2.8 Komisioni, hetoi lidhur me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm me shitësit e kësaj pasurie, për të cilën Prokuroria e Përgjithshme³², nuk konfirmoi ndonjë procedim penal të mosfilluar, të pezulluar apo të dërguar për gjykim për shtetasit Xh. Sh., B. Sh. dhe U. Sh. .

4.2.9 Komisioni, kreu analizën financiare mbi burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie. Nga përllogaritjet u konstatua se, subjekti³³ ka pasur burime financiare për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

4.2.10 Në përfundim të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime, lidhur me faktin se ai nuk kishte deklaruar në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2008, burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie.

4.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë fakt të konstatuar nga Komisioni

4.3.1 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij, pranë Komisionit si dhe në seancë dëgjimore, ndër të tjera, ka parashtruar se:

- Fakti që është konstatuar nga Komisioni se kam pasur burime financiare për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, nënkupton që gjetja e konstatuar është një pasaktësi në deklaram. Pasaktësitë në deklaramet periodike janë për shkak të mungesës së përvojës trajnimeve apo informacioneve të nevojshme lidhur me plotësimin e formularëve të deklaramit. Subjekti ka pranuar se kemi të bëjmë me pasaktësi dhe jo me mosdeklarim të burimit të të ardhurave.

4.4 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

4.4.1 Trupi gjykues në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe parashikimit të bërë në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, në të cilin thuhet shprehimisht se: “*Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre...*”, arrin në konkluzion se:

- ✓ Mosdeklarimi i burimit të krijimit të kësaj pasurie, në deklaratën periodike, është një pasaktësi në deklaram në vitin 2008, duke vlerësuar se ky veprim i subjektit konsiderohet si i tillë në harmoni me faktin se ai e ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, si dhe ka aftësi financiare për blerjen e kësaj pasurie.

5. Mbi pasurinë tokë arë, me sip. 207 m², në fshatin F., Tiranë, me nr. pasurie (*), zk (***), vol. (***), fq. (***), përfituar me kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme, nr. (***), datë**

³²Referojuni shkresave nr. (***), datë 21.01.2019 dhe nr. (***), datë 22.01.2019, në dosjen e Komisionit.

³³ Për të ardhurat e subjektit janë marrë për referencë të ardhurat nga pagesat e përfituara nga ndjekja e studimeve në shkollën e Magjistraturës. Shpenzimet për jetesë janë llogaritur deri në deklaramin e blerjes së kësaj pasurie.

22.12.2011, e lidhur përpara noterës A. A., midis palës shitëse Xh. dhe B. Sh. dhe blerësit Fatmir Lushi³⁴, në vlerën prej 72.450 lekësh.

Pjesë zotëruese: 100%. Burim krijimi: *kursimet nga të ardhurat nga paga si prokuror dhe paga e bashkëjetueses si mësuese.*

5.1 ILDKPKI-ja, në raporti e përcjellë është shprehur se: *“Vlera e blerjes së tokës arë me sip. 207m², në vlerën 72.450 lekë ose 350 lekë/m² është e dyshimtë për faktin se zona është në zhvillim dhe me kërkesa në rritje të vazhdueshme prej vitesh.”*

5.2 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ.

5.2.1 Rezulton se në deklaratën periodike të vitit 2011, deklaror kontratë shitblerje pasuri të paluajtshme, tokë arë me sipërfaqe 207 m², në fshatin F., Tiranë, në vlerën prej 72.450 lekësh, pa deklaruar burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie.

5.2.2 ZVRPP-ja³⁵ Tiranë konfirmon se, ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të z. Fatmir Lushi, pasurinë nr. (***) , zk (***) , vol. (***) , fq. (***) , me sip. 207 m², lloji i pasurisë arë.

5.2.3 Nisur nga konkluzioni i ILDKPKI-së për sa i përket dyshimit të shumës së paguar për këtë pasuri, ndërkohë që zona është në zhvillim dhe me kërkesa në rritje të vazhdueshme prej vitesh, ZVRPP-ja³⁶ Tiranë ka konfirmuar se çmimi i referencës për shitblerjen e pasurive të paluajtshme të ndodhura në në zk (***) , në vitin 2011, kanë qenë në vlerën 4.480 lekë/m².

5.2.4 Njësia Administrative³⁷ F., ka konfirmuar se në listat që ajo disponon lidhur me dhënien e lejeve të ndërtimit shtetasve të ndryshëm, nuk rezulton i listuar subjekti i rivlerësimit si dhe personat e lidhur me të, apo të tjerë të lidhur.

Komisioni kreu analizën financiare për burimet e ligjshme³⁸ të përdorura prej subjektit të rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie, në vitin 2011.

5.2.5 Nga përlllogaritjet financiare rezulton se subjekti ka pasur burime financiare për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

5.2.6 Nga analiza e fakteve të sipërpërmendura, Komisionit i rezultoi si vijon, dhe për pasojë i kaloi barrën e provës subjektit, se:

- i. Vlera e shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2011, nuk i referohet ekzaktësisht çmimit të referencës së konfirmuar nga ZVRPP-ja Tiranë për shitblerje pasurie, për këtë vit, madje ajo është disa herë më e vogël, se sa në fakt ajo duhej blerë.
- ii. Nuk përputhet vlera e shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie me çmimin e referencës së dhënë nga ZVRPP-ja Tiranë.
- iii. Subjekti nuk kishte deklaruar në deklaratën për vitin 2011, burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie.

³⁴ Certifikata e pasurisë në emër të z. Fatmir Lushi, lëshuar më datë 03.01.2012, në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁵ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 17.08.2018, në dosjen e Komisionit.

³⁶ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 11.01.2019, në dosjen e Komisionit.

³⁷ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 10.01.2019, në dosjen e Komisionit.

³⁸ Për të ardhurat e subjektit janë marrë për referencë të ardhurat e deklaruara *“kursimet nga të ardhurat nga paga si prokuror nga viti 2011”*. Për të ardhurat e bashkëjetueses së subjektit janë marrë për referencë të ardhurat e deklaruara nga *“paga e bashkëjetueses si mësuese”*, për vitin 2011. Në kolonën e 1-rë, përlllogaritjet pasqyrojnë vlerën e Kontratës për blerjen e tokës arë, me çmimin 350 lekë/m². Në kolonën e dytë, përlllogaritjet pasqyrojnë vlerën e Kontratës për blerjen e tokës arë, me çmimin 4,480 lekë/m².

5.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto fakte të konstatuara nga Komisioni:

5.3.1 Subjekti i rivlerësimit ndër të tjera, ka parashtruar:

5.3.1.a Në lidhje me vlerën e shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2011, se çmimi i referencës për shitblerjen e pasurive të paluajtshme në zk (***) , në vitin 2011 ka qenë në shumën 4480 lekë/m², kjo pasaktësi ka ardhur si pasojë e informacionit të gabuar që ka ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë. Në vitin 2011 (vijon subjekti), ka qenë në fuqi e njëjta VKM e vitit 2008, VKM-ja nr. 187, datë 06.03.2013, çmimin e referencës për këtë zonë e përcakton në vlerën 448 lekë. Vlera e shpenzuar, (është shprehur subjekti), i referohet ekzaktësisht çmimit të referencës si në vitin 2008. Subjekti për të qartësuar vlerën për m² të pasurisë, ka vënë në dispozicion edhe një kontratë shitblerje, datë 6.10.2008, të shtetasit Q. Sh., për pasurinë nr. (***)e ndodhur në po këtë zonë, në të cilën pasqyrohet vlera 350 lekë/m².

5.3.1.b Subjekti për të provuar se përse e ka blerë këtë pasuri krahas pasurisë së parë me sipërfaqe 276 m², arsyeton se gjatë kontaktit me specialistët e kësaj zyre i është sugjeruar që të blejë edhe një pjesë tjetër ngjitur pasi me hamendësimin e dhënieve të lejeve të ndërtimit sipërfaqja do të ishte shumë e vogël. Gjithashtu, ai sqaron se për pasurinë me sipërfaqe 276 m², pas studimit të planimetrisë, Zyra Urbanistike e kësaj Komune nuk i ka miratuar leje ndërtimi.

5.3.1.c Lidhur me mosdeklarimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën për vitin 2011, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim në shpjegime si në pasurinë nr. (***) .

5.4 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

5.4.1 Në analizë të parashtrimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar në prapësimet e tij, Komisioni, megjithëse konsideron referencën e parashikuar në VKM-në e vitit 2008 e cila ka vijuar të jetë në fuqi deri në blerjen e kësaj pasurie në vitin 2011, krijon bindjen se ka dyshime të arsyeshme të cilat mbetën të pamundura për tu provuar me gjithë hetimin e thelluar, se subjekti i rivlerësimit është trajtuar me çmim preferencial në blerjen e kësaj pasurie, për arsyet e renditura në vijim:

- Pasuria është blerë me të njëjtin çmim për m², disa vite më pas se pasuria e blerë në vitin 2008, me sip. 276 m²;

- Vërtetë vullneti i palëve në një marrëdhënie kontraktore është elementi bazë i saj, por shitja e një pronë private në një shumë minimaliste duket e sforcuar, ndërsa mund t'i referohej vlerës së tregut;

- Në këtë shitblerje palët kanë pasur interesa të ndërsjella, për faktin se, ashtu sikurse subjekti ka shprehur dhe realizuar interesin e tij për përfitimin e kësaj pasurie, nën hamendësimin se në një kohë të ardhme do të mund të përfitonte leje ndërtimi edhe pala shitëse nën këtë hamendësim ka qenë e interesuar të tjetërsojë (shesë) këtë pasuri, por kursesi me të njëjtën vlerë si tri vite më parë, *si dhe*;

- Kontrata e vënë në dispozicion si provë treguese se, në të njëjtën vlerë për m², ka blerë pasuri tek të njëjtët shitës edhe një tjetër shtetas me mbiemër *Sh.*, i përket vitit 2008 dhe jo vitit 2011.

- ✓ Në vlerësim të arsyetimit për sa më sipër, trupi gjykues çmon se, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse.

5.4.2 Ndërsa, lidhur me shpjegimet e dhëna nga subjekti mbi pasaktësinë e pretenduar për mosdeklarimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie në vitin 2011, Komisioni, vlerëson mbi të

njëtin arsyetim si në pasurinë e mësipërme me sipërfaqe 276 m², se ky veprim konsiderohet pasaktësi në deklaram.

6. Hapur depozitë kursimi për fëmijë, së bashku me bashkëjetuesen, znj. R. H., në emër të djalit, (***), më datë 01.8.2014, pranë “Raiffeisen Bank”. Vlera 204.000 lekë. Më datë 31.12.2015, interesi 5032.55 lekë. Më datë 30.12.2016, interesi 3202.18 lekë.

6.1 Burimi i krijimit: kursimet nga paga si prokuror dhe paga si mësuese e bashkëjetueses.

6.2 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë është shprehur se: *“Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes në dy data të ndryshme dhe konkretisht, deklarimi i përket, datës 30.12.2016, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 25.1.2017.”*

6.3 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ.

6.3.1 Komisioni kreu analizën financiare^[1], në lidhje me burimin e ligjshëm, për krijimin e këtij likuiditeti.

6.3.2 Në përfundim të hetimit u konstatua se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme në shumën prej 135.416 lekësh, për krijimin e këtij likuiditeti, për të cilin iu kërkuan shpjegime.

6.3.3 Subjekti në parashtrimet e tij ka pretenduar se ky konstatim nuk qëndron, për faktin se, janë përlloritur shpenzime transporti brenda vendit për nevoja të ushtrimit të funksionit të tij, si dhe shpenzime jetese, për një periudhë një mujore, 15 shkurt deri 15 mars 2014, kohë në të cilin ai ka qenë në SHBA për nevoja pune.

6.3.4 Komisioni rillogariti analizën financiare të këtij viti, pas së cilës rezultoi se subjekti gjendet përsëri në balancë negative në vlerën 64.855 lekë.

Në përfundim:

✓ Trupi gjykues çmon se, kjo diferencë nuk ndikon në këtë vendimmarrje.

7. Mbi depozitën bankare me afat 1-vjeçar së bashku me bashkëjetuesen, znj. R. H., me datë 22.2.2016, në Bankën Kombëtare Tregtare, në vlerën 1.500.000 lekë.

Burim krijimi: kursimet nga paga si prokuror. Pjesë zotëruese 50 % subjekti dhe 50% b/jetuesja.

7.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

7.1.1 Subjekti në vitin 2015 ka deklaruar, gjendje *cash* në vlerën 1.8 milion lekë, nga të cilat, vlera 91 412,98 lekë, është deklaruar dhe ka qenë gjendje pranë “BKT”-së në llogarinë e bashkëjetueses, ndërsa vlera 41 635. 21 lekë, është deklaruar dhe ka qenë gjendje pranë “Raiffeisen Bank” në llogarinë tuaj.

[1] Në analizë janë marrë në konsideratë: Depozitë për djalin në vlerën 204,000 lekë; *Cash* i deklaruar me vendndodhje në shtëpi, në shumën 800,000 lekë si dhe janë zbritur shpenzimet për periudhën 1 mujore të qëndrimit të subjektit në SHBA, këto të fundit qartësuar në parashtrimet e tij pas kalimit të barrës së provës.

7.1.2 Nga përlllogaritjet (*deklarimi në DVP-në 2015 gjendje cash 1,8 milion lekë*, duke zbritur dy vlerat e pasqyruara pranë “BKT”-së dhe “Raiffeisen Bank”) rezulton se subjekti realisht ka pasur jashtë sistemit bankar shumën 1,66 milion lekë (sipas tabelës).

Analiza financiare për vitin 2015

| | | |
|---|---|-----------|
| 1 | Gjendje <i>cash</i> e deklaruar | 1,800,000 |
| 2 | Gjendje në “BKT” në llogarinë e bashkëjetueses | 91,413 |
| 3 | Gjendje në “Raiffeisen Bank” në llogarinë e subjektit | 41,635 |
| | Gjendja reale <i>cash</i> (1-2-3) | 1,666,952 |

7.1.3 Komisioni ka konstatuar se subjekti ka mbajtur këtë shumë (1,666,952 lekë) jashtë sistemit bankar, në kundërshtim me ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar dhe për këtë i ka kërkuar të japë shpjegime.

7.2 Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se ky veprim nuk ka qenë i qëllimshëm, por ka qenë një pasaktësi në deklaram.

7.3 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në vlerësim të situatës faktike, konstaton se, subjekti me anë të shpjegimeve të tij, kërkon të thjeshtojë veprimin e kundërligjshëm të mbajtjes së gjendjes *cash* jashtë sistemit bankar duke e trajtuar këtë mosveprim si një proces që nuk duhet të kishte ndodhur, por vetëm duhej deklaruar. Mbi pretendimin e subjektit se rasti është thjesht dhe vetëm pasaktësi në deklaram, trupi gjykues çmon se, subjekti duhet të kishte ndërmarrë veprime për ligjërimin e kësaj shume nëpërmjet kalimit në sistemin bankar, sipas detyrimit ligjor të parashikuar në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar me ligjin nr. 45/2014, në nenin 4, pika 1, ku parashikohet se: “*Subjektet e këtij ligji, që plotësojnë deklaramin për herë të parë, sipas nenit 5/1 të tij, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në cash, jashtë sistemit bankar, mbi shumën 1,5 milionë lekë. Për subjektet që deklarojnë sipas nenit 5/1 të këtij ligji, depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve cash mbi vlerën e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private në ILDKPKI-së*”.

Për sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues, çmon se subjekti ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

8. Mbi deklaramin e gjendjes *cash* (kursime nga paga si prokuror së bashku me bashkëjetuesen si mësuese). Vlera 700.000 lekë. Zotëron 50 % dhe b/jetuesja 50 % tjetër.

- ✓ Komisioni kreu analizën financiare për burimin e ligjshëm të krijimit të këtij likuiditeti, nga ku i rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e gjendjes *cash*.

9. Mbi deklaramin e automjetit të markës “Daimler Crysler”, tipi C220 C I, vit prodhimi 2002, përfituar me kontratën e shitblerjes nr. (***) , datë 22.09.2016, në vlerën 380.000 lekë, vërtetuar me certifikatën e pronësisë në emër të z. Fatmir Lushi, lëshuar më datë 14.10.2016. Burim krijimi: Të ardhurat nga paga si prokuror dhe paga si mësuese e bashkëjetueses. Pjesë zotëruese: 100 %.

9.1 Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

9.1.1 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor me shkresën nr. (***) prot., datë 08.05.2018, konfirmon se në emër të z. Fatmir Lushi është regjistruar automjeti me targë (***). Sipas këtij dokumentacioni, subjekti me kontratën nr. (***), datë 22.09.2016, ka blerë këtë automjet nga shtetasi E. Rr. .

9.1.2 Nga shqyrtimi i praktikës nr. (***), datë 23.15.2018, të DPSHTRR-së, rezulton se automjeti është blerë në vlerën 380.000 lekë, aq sa është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, shumë kjo e paguar *cash* jashtë zyrës noteriale.

9.1.3 Komisioni kreu analizën financiare lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie.

- ✓ Në përfundim për këtë pasuri, trupi gjykues çmon se deklarimi i subjektit të rivlerësimit, përputhet me dokumentacionin e administruar dhe se subjekti ka burime të ligjshme për blerjen e saj.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Trupi gjykues çmon se:

- a- **Lidhur me kriterin e figurës**, subjekti i rivlerësimit, nga vlerësimi tërësor i fakteve dhe rrethanave, të lidhura me përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive përmes favorizimit të çështjeve penale të hetuara, raportit të DSIK-së, të dhënave të besueshme, si dhe bindjes së brendshme, ka cënuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
- b- **Lidhur me kriterin e pasurisë**, subjekti i rivlerësimit i) ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë 1; ii) nuk ka bërë deklaram të saktë lidhur me pasurinë 2; iii) ka vepruar në kundërshtim me ligjin për sa i përket mbajtjes së gjendjes *cash* jashtë sistemit bankar; iv) shpjegimet e tij për sa i përket vlerës së shpenzuar për pasurinë tokë “Arë” me sipërfaqe 207 m², nuk janë bindëse dhe për rrjedhojë ka vepruar në kundërshtim me pikat 1, 3 dhe 5 të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe me pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatorit të çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura prej tij, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, mbështetur në nenin 59, pika 1, të ligjit nr.84/2016, arrin në përfundim se subjekti i rivlerësimit:

- Nuk ka arritur një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës;
- Nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

PËR KËTO ARSYE:

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar, në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c” dhe pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Fatmir Lushi, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 26.03.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Suela Zhegu
Kryesues

Brunilda Bekteshi
Relatore

Xhensila Pine
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta